



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:225071
Datë: 02.06.2022
Numri i dokumentit: 03091852

K. Nr.1015/21

Gjykata Themelore Gjilan, - Divizioni i Kundërvajtjes: Gjyqtari Menderes Behluli dhe Praktikantja Vjollca Shabani, duke vendosur në lëndën kundërvajtje kundër të pandehurit A.S nga Gjilani, për shkak të veprës kundërvajtëse, të paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit **210 paragrafi 3**, lidhur me nenin **255 paragrafi 2, të LRRTRR-së nr 05/L-088**, e në bazë të **nenit 55** pika 1 dhe 2, 77, 86, 87, 119, dhe 124 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datën **02.06.2022**, shpall këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit A.S nga babai....., i lindur me....., me nr personal:në Gjilan rr.”.....,, i pa martuar, i pa punë, me gjendje së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Rep. Kosovës.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse me datë **13.09.2021**, aty rreth orës **14:30min**, i lartcekuri me automjetin e llojit motor të markës **“YAMAHA”**, pa tabela, pa patent shoferi, ka shkaktuar aksident komunikacioni në atë mënyrë duke lëvizur në rrugën **“.....”**, në afërsi të restaurant **“LULI”**, duke hyrë në rrugën e një kashe, (në drejtim të kundërt më saktësisht rruga nga restorant **“LULI”** që del përballë postes së madhe), në afërsi të kthesës ka shkaktuar një aksident trafiku, ku kishte goditur veturën e markës **“Shkoda”** taxi me targa **06-671-DT** në anën e përparme të anës së djathtë të kësaj veture ku ju kishin shkaktuar dëme materiale, ku vozitësi i kësaj veture ka qenë ankuesi i këtij rasti F.SH. Kundërvajtësi pas këtij aksidentit kishte vazhduar rrugën ishte larguar nga vendi i ngjarjes pa u marr vesh me të dëmtuarin dhe për këtë arsye i dëmtuari kishte njoftuar policin

- Me ç’veprim ka kryer veprën kundërvajtëse të paraparë dhe të sanksionuar me dispozitat e nenit **210 paragrafi 3**, lidhur me nenin **255 p.2 të LRRTRR-së, nr. 05/L-088**, të Kuvendit të Kosovës, andaj

D Ë N O H E T

ME DËNIM-GJOBË në shumë prej 150 (njëqindëepesdhjetë) euro, të cilën gjobë i pandehuri është e obliguar ta paguaj në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën e njëjta do të ekzekutohet me dhunë në kuptim të nenit 163 pra. 4 të LK.

I pandehuri obligohet që ne emër të shpenzimeve procedurale të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej **5 euro**.

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.
Nga një kopje e aktgjykimi t'iu dorëzohet palëve në procedurë .

A r s y e t i m

Stacioni Policor-së Gjilan, - ka parashtruar kërkesën me nr. **2021-CA-1269**, me datën **13.09.2021**, për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të lartëshënuar për veprën kundërvajtëse të parashikuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të ndeshkohet sipas ligjit.

Gjyqtari shqyrtoi kërkesën dhe konstatoi se e njëjta është e ligjshme. Gjyqtari me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, ftoi të pandehurin më ftesë për datën **23.03.2022**, I cili e pohoi veprën kundërvajtëse që i vihet në barrë, duke theksuar se vërtetë me datën **13.09.2021 në orën 14:30min**, në rrugën "Rexhep Dajkovci", afër "Restoran Luli" në Gjilan, është involvuar në aksident komunikacioni pa qëllim pa dashje edhe përkundër vozitjes më me kujdes i ka ndodhur ky aksidente, dhe për mos me ardhur deri një mosmarveshje me palën e kundërt është larguar nga vendi i ngjarjes ky ka qen qëllimi pse është larguar dhe për këtë kërkon falje kërkon ndjesë, është hera e parë që i ka ndodhur një veprim i tillë, dhe në gjykatë prezenton disa vërtetime mjeksore si dëshmi se është i smuar, dhe lut gjykatën që kësaj here mundësisht ti merr parasysh këto rrethana si lehtësuse, dhe me rastin e vendosjes ti shqiptoj një dënim sa më të vogël.

Gjyqtari pas shiqimit të shkresave të lëndës, dhe deklaratës së të pandehurit, erdhi në përfundim të plotë, se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elemente dhe prova të mjaftueshme, se i pandehuri ka kryer veprën kundërvajtëse e cila i vëhet në barrë, vepër kjo e paraparë dhe e sanksionuar me dispozitat e nenit **210 par 3, lidhur me 255 paragrafi 2, të LRRTRR-së nr 05/L-088**.

Gjatë matjes së dënimit, gjyqtari pati parasysh peshën dhe pasojat e veprës kundërvajtëse, rrethanat objektive dhe subjektive në të cilën është kryer kundërvajtja, rrezikshmërinë shoqërore dhe kështu që në vështrim të nenit **31 pika 1 të LMK-së**, mori

parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese dhe të pandehurin e ndëshkoi me gjobë nën minimumin e paraparë ligjor konform nenit **35 te LMK-së**, duke konsideruar se edhe me një lloj të tillë të dënimit do të arrihet qellimi i dënimit tek i pandehuri që në të ardhmen mos të përsëris kundërvajtje të tilla.

Vendimi mbi shpenzimet gjyqesore është marrë në bazë të nenit **59 par 1, të LMK-së**. Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm
Divizioni i Kundërvajtjes
Me dt: 02.06.2022

Praktikantja,
Vjollca Shabani

Gjyqtari,
Menderes Behluli

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, paraqitësi i kërkesës dhe pala e pandehur mund të paraqesin ankesë në afat prej 8 ditësh pas marrjes së të njëjtit aktgjykimi dhe ate Gjykatës së Apelit në Prishtinë, ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate.